

**Projekti:** IPA FF

**Aktiviteti 5.6:** Rritja e ndërgjegjësimit për zbutjen e rrezikut nga zjarret në pyje – IPAFF@school (IPA FF për shkollat)

Rregullat për konkursin e shkollave "**Luftimi i zjarreve: është radha ime!**"

## Fjala hyrëse

Në kuadër të nxitjes së bashkëpunimit rajonal, shkëmbimit të praktikave të mira dhe krijimit të aftësive për jetën në komunitetet lokale, programi IPA FF ka planifikuar aktivitetin 5.6: "**Rritja e ndërgjegjësimit për zbutjen e rrezikut nga zjarret në pyje – IPAFF@school**". Aktiviteti synon të rrisë ndërgjegjësimit mbi praktikat më të mira për menaxhimin e rrezikut të pyjeve dhe zjarreve nëpërmjet edukimit të nxënësve. Qëllimi i këtij aktiviteti është që nëpërmjet edukimit të studentëve, të rriten aftësitë për jetën në të gjithë shoqërinë.

Aktiviteti përfshin konkursin në shkollë me titull "**Luftimi i zjarreve: është radha ime!**" Në këtë dokument përcaktohen rregullat për konkursin.

## Pjesëmarrësit

Shkollat që marrin pjesë në aktivitetin IPAFF@school do të kenë një mësues referues dhe do të krijojnë ekipe me maksimumi 3-4 nxënës që marrin pjesë në konkurs. Ekipet do të kenë emrin e tyre, qytetin, emrin e shkollës, mësuesin referues dhe klasën.

## Kriteret për vizatimet

Vizatimet do të bëhen në një letër A4 ose A3; teknika e vizatimit dhe ngjyrat janë sipas dëshirës.

Ato do të paraqesin ose do të përfshijnë dy fjalë kyçe të aktivitetit si në vijim:

- Reflektimet – i referohet mësimëve të nxjerra nga fatkeqësitë në të kaluarën dhe rëndësisë së reflektimeve për rritjen dhe ruajtjen e ndërgjegjësimit se zjarret përbëjnë rrezik, por edhe se ekzistojnë mënyra për t'i menaxhuar ato.
- Veprimet – I referohet praktikave më të mira të menaxhimit të rrezikut të fatkeqësive për parandalimin, reagimin dhe rikuperimin.

## Kriteret e tjera materiale

Piktura duhet të përbëhet nga dy elementë:

- një përshkrim të shkurtër se si ai përfaqëson dy fjalët kyçe.
- një përshkrim rreth mënyrës së realizimit të punës, duke përcaktuar mënyrën e krijimit të idesë dhe cila ishte pjesëmarrja e anëtarëve të ekipit, çfarë përfaqëson piktura.



Rekomandohet krijimi i një videoje 30 deri në 60 sekonda për realizimin e pikturës, e cila është alternative, por do të shërbejë si një bonus.

## Dorëzimi

Mësuesi referues do të mbledhë projektin e pikturës ose dizajnit, dy përshkrimet dhe, nëse është ka, edhe videon.

Fotografia e pikturës, përshkrimet dhe videot do të dërgohen në adresën: [ipaffschools@gmail.com](mailto:ipaffschools@gmail.com). Afati i fundit për dorëzim do të jetë të martën më 13 shkurt 2024.

Emri i ekipit

## Vlerësimi

Piktura do të vlerësohet nga një komision i përbërë nga 2 përfaqësues të vendeve partnere të IPAFF dhe 2 ekspertë të komunikimit të rrezikut. Secili vend partner atje do të ketë komisionin e tij dhe nuk do të zhvillohet vlerësim mes vendeve.

Kriteret e vlerësimit do të jenë si në vijim:

- pjesa vizuale do të përbëjë 20% të vlerësimit
- mesazhi që përcjellë do të përbëjë 25% të vlerësimit
- përshtatja e fjalëve kyçe do të përbëjë 15% të vlerësimit
- origjinaliteti do të përbëjë 20% të vlerësimit
- krijimi i videos do të përbëjë 20% të vlerësimit të ndarë si më poshtë: 10% do të jetë vetëm për paraqitjen e videos përveç materialit të detyrueshëm dhe 10% për realizimin e një videoje tërheqëse.

## Çmimet

Piktura ose projekti fitues do të rikrijohet në një format më të madh në një sipërfaqe muri të caktuar nga përfaqësuesit e IPAFF në çdo vend partner. Nxënësit në çdo ekip do të marrin si dhuratë pajisje të zgjedhura nga përfaqësuesit e IPAFF në secilin vend partner.

